

JETA SHKENCORE**KONFERENCË SHKENCORE “STUDIME LETRARE NË PROCES,
PERSPEKTIVA E QASJE TË REJA ZHVILLIMI”**

Më datën 29 qershor 2023, pranë Muzeut Arkeologjik të Akademisë së Studimeve Albanologjike u mbajt konferenca shkencore “Studime letrare në proces, perspektiva e qasje të reja zhvillimi”, si një veprimtari e përvitshme e organizuar nga Departamenti i Studimeve Letrare i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Në fjalën e saj të hapjes, prof. as. dr. Evalda Paci, përgjegjëse e Departamentit të Studimeve Letrare iu referua tematikave të lëvruara ndër vite në kuadër të kësaj konference, që përkojnë me një sërë iniciativash kërkimore e bashkëpunimesh me të tjera institucione të kërkimit shkencor në vendin tonë. Në fjalën e tij përshëndetëse, drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (ASA), prof. dr. Artur Lama nënvizoi rëndësinë e mbajtjes së kësaj konference shkencore dhe prirjet e shprehura në kontributet që janë reflektuar në vijimësinë e saj.

Në seancën plenare të konferencës referuan: Stefan Çapaliku, me kumtesën “*Letërsia dhe qyteti (Korçë e Shkodër)*”; Tomorr Plangarica, me kumtesën “*Etosi diskursiv, si zgjerim i përmasave të etosit në studimin e diskursit letrar*”; Flamur Maloku, me kumtesën “*Studimet letrare në Kosovë (2000-2010)*”; Labinot Berisha, me kumtesën “*Disa veçori të këngëve kreshnike shqiptare*”; Merxhan Avdyli, me kumtesën “*Të tjerët për Agollin*”; Fikret Ramadani, me kumtesën me titull “*Rubairat*” në letërsinë shqipe – autenticiteti dhe apokrifiteti”; Olimbi Velaj, me kumtesën “*Probleme të receptimit të poezisë pas vitit '90; përfaqësimi e promovimi referuar çmimeve vjetore*”; Evalda Paci, me kumtesën “*Historia e letërsisë së shkruar shqipe, mes domosdoshmërisë dhe përfaqësimit teorike*”.

Në seancën e parë paralele u mbajtën kumtesa mbi vështrime filologjike dhe çështje të studimit tekstor të veprave të letërsisë shqipe, por dhe mbi përkime e bashkëlidhje mes traditash në lidhje me studimet letrare. Referuan përkatësisht: Merita Bruçi - Engjëllushe Karaj, me kumtesën “*Cilin Serembe të besojmë? Në kërkim të vargjeve të “Elegji”-së*”; Ermira Alija - Klodjanë Marticanaj, me kumtesën “*Mbi receptimin e letërsisë filo-biblike. Propozime të interdisiplinaritetit si formë alternative për studimin e saj*”; Arian Leka, me

kumtesën “Aspekte të statusit pragmatik në veprën “*Letra grues seme të vdekun*” (dëshmi mbi autorësinë, zhanrin, modelet, versionet përkthimore dhe elementet e stilit)”; Ermir Xhindi, me kumtesën “*Semiotika e hapësirave bosh në tekst gjatë leximit, si funksion i groteskut në romanin “Arka e Djallit” të Dritëro Agollit*”; Mimoza Pillana (Hasani), me kumtesën “*Gruaja autore në një moment të veçantë të historisë së letërsisë shqipe*”; Mimoza Priku, me kumtesën “*Tekstet liturgjike përshtatur nga Ndre Mjedja, mbështetje për hartimin e fjalorit të tij nga Kolë Ashta*”; Skënder Karriqi, me kumtesën “*Modeli homerik i transmetimit dhe modeli polifonik shqiptar*”; Neli Naço, me kumtesën “*Fryma e imazhit në botën e romanit “Lumi i vdekur” të Jakov Xoxës: Kërkime në tipologjinë e llojeve*”; Edelajda Cenaj, me kumtesën “*Ditaret dhe letërkëmbimi si dëshmi me vlerë e elementeve artistiko-letraro dhe gjuhësore*”.

Në seancën e dytë paralele u mbajtën kumtesa mbi çështje të shtypit kulturor e atij letrar në revista të specializuara, mbi çështje të didaktikës së letërsisë e të receptimit të tekstit letrar në shkolla, mbi mendimin filozofik të reflektuar në vepra të letërsisë shqipe. Në këtë seancë referuan përkatësisht: Ermira Ymeraj- Klodeta Dibra, me kumtesën “*Shtypi i shkruar dhe letërsia shqipe (aspekte krahasuese mes periodikëve)*”; Virion Graçi, me kumtesën “*Dy romane të Kasëm Trebeshinës në dy kohë kulturore: “Qezari niset për luftë” dhe “Odin Mondvalsen”*”; Edlira Macaj, me kumtesën “*Historiografi letrare në proces - nga utiliteti te literaliteti*”; Natasha Poroçani, me kumtesën “*Problematika të trajtimit të materialit letrar në arsimin e mesëm të lartë (vështrim në sinkroni)*”; Edlira Gugu, me kumtesën “*Metodat e interpretimit letrar - sfidat e qasjes praktike në mësimdhënie*”; Nurie Emrullai, me kumtesën “*Poetika e dëbimit - Ekzili, identiteti dhe nostalgjia në prizmin letrar*”; Rovena Vata, me kumtesën “*Personalitete të letrave shqipe dhe bashkëkohës të Gjergj Fishtës në shkrimet e tij publicistike*”; Mirela Shella, me kumtesën “*Femërorja dhe feminizmi tek shkrimtarët shqiptarë*”; Bertina Salliu, me kumtesën “*Botimi i librave fetarë në gjuhën shqipe nën ndikimin e misionëve protestante (fundit i shek. XIX - fillimi i shek. XX)*”; Blerina Harizaj, me kumtesën “*Ridimensionimi i koncepteve filozofiko perso-arabe në poezinë naimiane*”.

Evalda Paci